



Çdo herë kur leni një ambalazh apo gazetë për t'u recikluar ndodhë diçka e madhe. Kapaku i vjetër shndërrohet në vidhë. Nga ambalazhi i paluar i detergjentit bëhet një kuti e bukur kartoni këpucësh. Nga gazeta e lexuar bëhet një gazetë e re. Në këtë mënyrë ju ndihmoni që një sasi e madhe e energjisë të kursehet. Kështu mirëmbahet edhe qarkullimi i lëndëve të para në natyrë. Falë kujdesit tuaj ambienti fiton shumë. Por edhe ju shpërbleheni nga e gjithë kjo, çdo herë që recikloni.

Ambalazhet dhe gazetat në qarkullim

Të gjitha ambalazhet dhe gazetat që grumbullohen për reciklim shndërrohen në ambalazhe të reja apo prodhime tjera. Nga plastika mund të bëhet rrethojë për mbrojtje nga zhurma, brushë për larje enësh, saksii lulesh, qese najloni etj. Qelqi, letërkartoni dhe paketime tjera prej letre shndërrohen zakonisht në ambalazh të ri. Nga ambalazhet metalike mund të bëhet binarë hekurudhe, karroceri automjetesh dhe shumë gjëra tjera. Nga gazetat e lexuara bëhen gazeta të reja.

Përgjegësia e sipërmarrjeve

Qeveria ka vendosur që të gjitha firmat që prodhojnë, importojnë ose shesin ambalazh apo artikuj të ambalazhuar duhet të mbajnë përgjegjësinë që të ketë sistem grumbullues sipas të cilit konsumatorët do të mund të udhëhiqen në grumbullimin e ambalazheve për reciklim. Ky sistem quhet përgjegjësi e sipërmarrjeve. Kjo vlen edhe për gazetat dhe letrën recikluese. Ata që prodhojnë ose importojnë letër gazete apo shtypin ose importojnë gazeta mbajnë poashtu përgjegjësinë që letra të grumbullohet për t'u recikluar. Ambalazhi dhe gazetat janë llojet e para të artikujve ndaj të cilëve është aplikuar përgjegësia e sipërmarrjeve. Këto përbëjnë një sasi të madhe të mbeturinave dhe janë relativisht të lehta për t'u recikluar. Prodhuesit e ambalazheve dhe të letrës recikluese kanë një emërtim të përbashkët, FTI (Förpacknings- och Tidningsinsamlingen – Grumbullimi i ambalazheve dhe gaze-tave). Kjo veprimtari nuk ka për qëllim përfitim material.

Stacione reciklimi

FTI mban përgjegjësinë për 5 800 stacione reciklimi në Suedi. Në këto stacione grumbullohen ambalazhe plastike, letre, metali dhe qelqi. (Në disa stacione ka bile edhe vend ku grumbullohen bateritë dhe tekstili).



www.ftiab.se, tel 0200-88 03 11

* Qendra për grumbullimin e ambalazheve dhe gazetave

Klasifikimi i ambalazheve

Ambalazhet që hidhen duhet të jenë të zbrazura dhe të pastra. Ambalazhet që përbëhen nga materiale të ndryshme duhet të ndahen. Nëse nuk është e mundur që materialet e ndryshme të një ambalazhi të ndahen atëherë ambalazhi klasifikohet sipas materialit dominues.



AMBALAZHE PLASTIKE

Ambalazhe nga plastika e fortë

Shembull: shishet, kanaçet (konzervat), bidonë, dhe kofat e vogla.

Ambalazhe nga plastika e butë

Shembull: qese najloni, paketime rimbushëse, foli plastike dhe film fotoaparati (celuloid).

Veproni në këtë mënyrë: Grumbullimi ambalazheve të plastikës së fortë dhe të butë bëhet në të gjitha stacionet, mirëpo grumbullimi bëhet në dy mënyra të ndryshme. Në disa raste ato grumbullohen në një vend, gjë që ndodh shpesh. Ose ato grumbullohen në vende të veçuara, plastika e butë në një vend dhe plastika e fortë në një vend tjetër. Rregullat për klasifikimin e ambalazheve zakonisht janë të shënuara në kontejnerët për grumbullim. Kjo vlen edhe për vendgrumbullimet lokale. Hiqni tapat dhe kapakët. Zbrazni qesen me ambalazh plastike në kontejner që ambalazhet të jenë të ndara, kështu lehtësohet reciklimi.

Veni re! Gjësende plastike (si p. sh. mobilje apo lodra), që nuk janë ambalazhe hidhen në vendgrumbullimet për mbeturina të mëdha. Shishet e plastikës ndërkaq kthehen nëpër shitore.



AMBALAZHE LETRE

Shembull: thasë sheqeri, paketime pastash (makarona etj), letër për mbështjellje dhuratash, kutia qumështi dhe lëngjesh, kuti këpucësh, rul letre toaleti, mbështjellës librash apo CD pllakash si dhe letërkartoni.

Veproni në këtë mënyrë: Paloni ambalazhet. Ambalazhet e vogla i futni në ato të mëdha.

Veni re! Zarfat hidhen me mbeturinat tjera shtëpiake (ose në vendin ku grumbullohen lëndë djegëse, nëse ekziston një vend i tillë). Gazetat, broshura reklame dhe të ngjashme hidhen në kutinë e posaçme për gazeta.



AMBALAGHE NGA METALI

Shembull: konzerva, konzerva spreji, tubëfishekë, kapakë, kutia të thara ngjyrash, folie dhe kallëpe alumini.

Veproni në këtë mënyrë: Kapakët e mprehtë i futni në konzervë. Kapaku i tubëfishekut të kaviarit nuk hiqet.

Veni re! Kutitë me ngjyra dhe ngjitës hidhen si mbeturina të rrezikshme. Hekurishtat, pjesë mjetesh ujëinstaluese, fultere dhe prodhime tjera që nuk janë ambalazhe hidhen në vendgrumbullim për mbeturina të mëdha. Kanaçet e pijeve kthehen në shitore.



AMBALAGHE QELQI

Shembull: shishe dhe konzerva qelqi të ngjyrosur dhe të pangjyrosur.

Veproni në këtë mënyrë: Heqni tapën ose kapakun dhe i ndani sipas llojit të materialit.

Veni re! Shishet 33 dhe 50 cl kthehen me kaucion në shitore. Porculani, qeramika, dhe qelq tjetër që nuk janë ambalazhe hidhen me mbeturinat e tjera shtëpiake si mbeturina të mëdha. Llamba elektrike dhe gype neoni nuk hidhen në vendgrumbullime qelqi, ato zakonisht hidhen në vende të posaçme grumbullimi të komunës. Për informata më të hollësishme kontaktoni komunën tuaj.



GAZETA

Shembull: Gazeta ditore dhe javore, revista, katalogë, broshura reklame dhe letër vizatimi.

Veproni në këtë mënyrë: Para se të hudhni gazetën hiqni qeset e najlonit dhe pusulla të ngjitura reklame.

Veni re! Zarfat hidhen me mbeturina shtëpiake (ose në vendin ku grumbullohen lëndë djegëse, nëse ekziston një vend i tillë)